

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Financat Publike II
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	Prej lindjes deri në vdekje, jeta jonë është e ndikuar në shumë mënyra nga veprimet e qeverisë. Qeveritë janë organizata të formuara për të ushtruar pushtet mbi veprimet e njerëzve të cilët jetojnë sëbashku në shoqëri dhe për të siguruar dhe financuar shërbimet qenësore. Financat Publike janë pjesë e ekonomiksit që studiojnë funksionimin e qeverisë dhe mënyrat alternative të financimit të shpenzimeve të qeverisë. Nëse studioni Financat Publike, do të fitoni njohuri lidhur me bazën ekonomike të funksionimit të qeverisë. .
Qëllimet e lëndës:	Programi ka për qëllim të ofrojë njohuri të avancuara, të njohë dhe aftësojë studentët për përdorimin specifik të koncepteve, metodave, teorive dhe politikave të financave publike në mënyrë që ata t'i aftësojë të shpjegojnë dhe interpretojnë probleme të veçanta, të bëjnë ndërlidhjen e këtyre problemeve me fushat e tjera ekonomike, të formulojnë opinione të qëndrueshme nga fusha e financave publike dhe fushat e ndërlidhura, të zgjidhin problemet në kontekst të ri, të reflektojnë në mënyrë kritike në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve nga kjo fushë dhe ndërlidhur me fushat e tjera.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët do të aftësohen për të vlerësuar: <ul style="list-style-type: none"> • rolin dhe madhësinë e sektorit publik, përfshirë edhe ndërhyrjen racionale të sektorit publik në rregullimin e mangësive të tregut; • politikat e redistribuimit; • mobilizimin e resurseve publike përfshirë ekonominë e tatimeve, të ardhurat nga tatimet, pasurinë, tregun dhe reformat e tatimeve; • politikat e shpenzimeve publike, • bilancin fiskal,

	<ul style="list-style-type: none"> financimin e deficitit dhe relacionet ndërqeveritare fiskale.
Metodat e vlerësimit:	Në përputhje me statusin e UP “H.P”
Literatura	
Literatura bazë:	D.N.Hyman:”Public Finance, A Contemporary Application of Theory to Policy”, 10 th ed., South-Western, Cengage Learning, 2010. Harvey S. Rosen:” Public Finance”, Sixth Edition, McGraw-Hill/Irwin, New York, 2002
Literatura shtesë:	Dr. Sabahudin Komoni:”Financat Publike”, Prishtinë, 2008 Mario Leccisotti:”Leksione të shkencës së financave”, përkthim, elite, botim i parë, Tiranë, 2000. Public Finance in Developing and Transitional Countries, Edited by Jorge Martinez-Vazques and James Alm, Georgia State University, USA
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Qasja makroekonomike dhe mikroekonomike në financat publike.
Java e dytë:	Alokimi i resurseve ndërmjet qeverisë dhe përdorimit privat. Efiçenca, tregu dhe qeveria. Ekonomiksi pozitiv dhe normativ.
Java e tretë:	Shpërndarja si objektivi i përgjithshëm i ndërhyrjes publike; Drejtësia e shpërndarjes; Barazia dhe paanësia.
Java e katërt:	Parimet e tatimeve; Ndarja e barrës tatimore; Tatimet mbi të ardhurat: Tatimet mbi të ardhurat e korporatave; Tatimet mbi konsumin dhe shitjen; Tatimet mbi pasurinë.
Java e pestë:	Ndikimi i tatimeve në çmimin e tregut, në efiçencën dhe në zhvillimin ekonomik; Roli i tatimeve në konsum dhe shpërndarje; Rritja ekonomike.
Java e gjashtë:	Influencimi i tatimpaguesve; Lartësia e normave tatimore; Kontrolli i shpenzimeve publike; Pasojat e evazionit; Roli i administratës tatimore.
Java e shtatë:	Ekulibri buxhetor. Borxhi qeveritar. Huamartja nga shteti dhe pushteti lokal. Kursimet kombëtare dhe ekuilibri i përgjithshëm buxhetor.
Java e tetë:	Federalizmi fiskal; Relacionet ndërqeveritare fiskale; Tatimet në sistemin e decentralizuar. Sfidat e decentralizimit fiskal në vendet e zhvilluara dhe ato në tranzicion.
Java e nëntë:	Investimet publike; Analiza kost benefit; Procesi buxhetor;
Java e dhjetë:	Subvencionet dhe transferet. Ndikimi i programeve të asistencës për të varfërit; Sigurimet shoqërore dhe kujdesi shëndetësor.